



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË

V E N D I M
PËR MOSFILLIMIN E ÇËSHTJES PENALE
(lidhur me kallëzimin penal nr.6227/2021)

Në Tiranë, sot në datën 08.06.2021.

Unë, Ornela Rrumbullaku, Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi studiova materialin kallëzues nr. 6227 datë 24.05.2021, të regjistruar mbi bazën e kallëzimit nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë,

K O N S T A T O V A:

Se më datë 24.05.2021, është regjistruar kallëzimi penal i Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Gazmend Bardhi, Sekretar i Përgjithshëm i saj, kundër shtetasve [REDACTED] dhe [REDACTED], si dhe ndaj [REDACTED], [REDACTED]

[REDACTED] Ky kallëzim penal është depozituar në Prokurorinë e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë më datë 08.04.2021 për veprat penale të parashikuar nga nenet 248, 328 dhe 328/a i Kodit Penal.

Prokuroria e Posacme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar me shkresën nr.285/1 prot./M.K datë 12.04.2021 ka përcjellë për kompetencë materialin kallëzues, pasi ka konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për veprën penale të “Korrupsionit aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal. Dhe nga ana tjetër është konkluduar se SPAK nuk është kompetent për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 dhe “Përdorim të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikuar nga neni 328/a i Kodit Penal.

Ky material kallëzues është regjistruar si i tillë më datë 24.05.2021 dhe është hedhur në short elektronik më datë 28.05.2021.

Nga ky material kallëzues pretendohet se nga punonjës të policisë së Komisarariatit të Policisë nr.4, janë kryer veprime të kundraligjshme duke përdorur funksionin e tyre publik për veprimtari politike pse zgjedhore për të ndikuar tek vullneti i qytetarëve për të votuar Partinë Socialiste.

Më konkretisht pretendohet se një javë para se të depozitohet kallëzimi penal, punonjësit e policisë [REDACTED] dhe [REDACTED] kanë shkuar në një biznes në zonën e Freskut, dhe janë përballuar me reagimin e personave që kanë qenë në atë biznes, deri në konfrontim fizik me këta shtetas. Nga subjekti politik pretendohet se kjo ngjarje kriminale është fshehur nga policia për shkak se shkelësit e ligjit ishin vetë punonjësit e policisë.

Kuadri Ligjor:

Neni 248 i Kodit Penal, "Shpërdorimi i detyrës" parashikon se: "*Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet*".

Neni 328/a i Kodit Penal, "Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", parashikon se:

"Pjesëmarrja e një punonjësi që kryen një detyrë shtetërore në shërbimin civil ose në një funksion jopolitik në administratën shtetërore, në kundërshtim me ligjin, në aktivitetet ose fushatën zgjedhore, të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose organizimi për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor i nxënësve të arsimit parauniversitar nga punonjës që kryejnë një detyrë shtetërore në arsimin publik, ose detyrë a funksion në arsimin jopublik, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Detyrimi ose kërkesa drejtuar shtetasve, nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, që kundër vullnetit të tyre ose nën kërcënimin e përdorimit të masave administrative ose disiplinore, për të marrë pjesë në veprimtari zgjedhore të një subjekti zgjedhor, për të marrë ose jo pjesë në zgjedhje, për të mbështetur ose jo një parti politike ose një kandidat në zgjedhje, ose për të votuar në një mënyrë caktuar, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet.

Përdorimi nga një punonjës që kryen një detyrë shtetërore, i të mirave publike, funksionit ose veprimtarisë shtetërore, ose i burimeve financiare ose njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një vit deri në tre vjet."

Nga verifikimi dhe nga analiza e kryer në raport me veprën penale për të cilën është referuar materiali rezulton se:

Materiali kallëzues i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, nuk përmban elementë të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore", parashikuar nga nenet 248 dhe 328/a të Kodit Penal dhe si i tillë ai duhet të mosfillohet. Shpërdorimi i detyrës kërkon si element të domosdoshëm kryerjen e veprimeve/mosveprimeve me dashje dhe në kundërshtim me ligjin ***me qëllim sjelljen e një pasoje që*** është një përfitim ose një dëmtim, për vete ose për të tretë.

Nga sekretaria e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor është bërë verifikimi i ndonjë materiali kallëzues për periudhën 27.03.2021-07.04.2021, ku të jenë përfshirë punonjësit e policisë [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për ndonjë ngjarje në zonën e Freskutt, referuar episodit të përmendur në materialin kallëzues të subjektit politik.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se më datë 30.03.2021 nga ana e punonjësve të Policisë së Komisarariatit nr.4 Tiranë [REDAKTUAR] është bërë kallëzim penal për veprën penale të "Goditje për shkak të detyrës", parashikuar nga neni 237 të Kodit Penal, për shkak se në orën 20.15 të datës 30.03.2021, në rrugën e Dajtit, përballë restorant Fresku, dy punonjësit e policisë duke patrulluar me automjetin e tyre, janë përballuar me goditjen fizike nga shtetasi [REDAKTUAR]. Pas konfrontimit fizik me këtë shtetas, ky shtetas ka arritur t'u largohet punonjësve të policisë dhe është ndaluar më datë 03.04.2021, duke vazhduar më tej procedurat ligjore të vleftësimit të ligjshëm të ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit

nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky fakt penal është duke u hetuar në kuadër të procedimit penal nr. 2336 datë 03.04.2021 nga prokurore [REDACTED]

Për sa më lart, nga verifikimet e kryera rezultoi se pretendimet e kallëzuesit nuk janë të bazuara në aktet e verifikuara nga organi procedues, pasi pretendimi se nga ana e punonjësve të policisë të Komisarariatit të Policisë nr.4, Tiranë, është fshehur një fakt penal, ku janë përfshirë vetë punonjësit e policisë në një konfrontim fizik në zonën e Freskut nuk qëndron, përse kohë ka një procedim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor që po hetohet nga kjo prokurori.

Pretendimet e tjera të subjektit politik se punonjës të policisë së Komisarariatit nr.4 Tiranë kanë liruar ose mosproceduar shkelës të ligjit që janë votues të Partisë Socialiste, nuk është shoqëruar me asnjë rast konkret se në ç'rrethana janë liruar apo mosproceduar shkelës të ligjit, me qëllim verifikimin nga ana jonë të çdo rasti konkret.

Sa më sipër në kushtet kur në këtë kallëzim penal nuk evidentohet asnjë rast konkret, ku të jenë konsumuar elementët e veprës penale të "*Shpërdorimit të detyrës*", apo të "*Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore*", parashikuar nga nenet 248 dhe 328/a të Kodit Penal, ky material kallëzues duhet të mosfillohet.

Për këto arsye mbështetur në nenet 290/1 gërma ç) dhe 291/1/2 të K.Pr.Penale:

V E N D O S A:

- Mosfillimin e procedimit penal, që ka të bëjë me kallëzimin penal nr. 6227 datë 24.05.2021 pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
- Njoftimin e palës kallëzuese subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë në lidhje me vendimin, i cili ka të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

PROKURORI
Ornela RRUMBULLAKU

